

VENDIM
Nr. 153, datë 31.7.2024

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “ALBANIA POWER CORE” SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1662/1 prot., datë 26.7.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Albania Power Core’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Albania Power Core” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1662 prot., datë 19.7.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet prodhues 40.56 mw dhe veprave ndihmëse, në Fshatin Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në pikën 1.1, gerrat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gerrat “a” dhe “c”; për pikën 2.1 gerrat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “Albania Power Core” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 1215 rep., nr. 1045 kol., datë 3.5.2024, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 40.56 mw, i cili nuk është objekt koncesioni, dhe veprave ndihmëse, në fshatin Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria “Albania Power Core” sh.p.k.”;

- Ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” marrëveshjen nr. 2560/8 prot., datë 3.7.2024, për lidhjen e centralit fotovoltaiik të shoqërisë “Albania Power Core” sh.p.k. me rrjetin e transmetimit;

- Është pajisur me vendim për VNM-në paraprake, lëshuar më 7.12.2022 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i parkut fotovoltaiik Sheq Marinas”, për fuqinë 40.56 mw.

- Nga ky aplikimi nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni në vijim:

Neni 9

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.3

- **Germa “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacion që vërteton aftësinë financiare për realizimin e investimit për ndërtimin e parkut fotovoltaiik, referuar parashikimeve të planit të biznesit për mënyrën e financimit.

- Gjithashtu, shoqëria duhet të bëjë me dije nëse kanë nisur punimet për ndërtimin e veprës.
Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Albania Power Core” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet prodhues 40.56 mw dhe veprave ndihmëse, në Fshatin Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Albania Power Core” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti